VENDIM
Nr.60, datë 29.8.2008

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
"PËR KËRKESAT MINIMALE TË PUBLIKIMIT TË INFORMACIONIT NGA BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 47, pikat 3 dhe 4 dhe të nenit 53 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
PËR KËRKESAT MINIMALE TË PUBLIKIMIT TË INFORMACIONIT NGA BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave minimale, i mënyrave dhe afateve lidhur me informacionin që duhet publikuar në raportet periodike të bankave dhe degëve të bankave të huaja, në funksion të rritjes së transparencës dhe nxitjes së disiplinës në tregun bankar, si dhe për të siguruar qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e sistemit bankar.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregullore janë bankat dhe degët e bankave të huaja (që më poshtë për thjeshtësi do të quhen me emrin e përbashkët "banka"), të cilat janë të licencuara të ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12 dhe shkronjës ”c” të nenit 43, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar (më poshtë ligji “Për Bankën”) të pikës 2, të nenit 47, pikat 3 dhe 4 dhe të nenit 55 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" (më poshtë ligji “Për bankat”).

Neni 4
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4 të ligjit “Për bankat”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Publikim” është vënia në dispozicion e informacionit për përdoruesit: publikun, pjesëmarrësit e tregut, investitorët, punonjësit, kreditorët, klientët, qeveritë dhe organizmat e tjerë sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

b) “Informacion cilësor” është informacioni mbi objektivat, politikat dhe strategjitë e shkruara të bankës, metodat, proceset, strukturën, organizimin e funksionet e administrimit të rreziqeve, qeverisjen e bankës, politikat kontabël të përdorura etj.

c) “Informacion sasior” janë të dhënat numerike të përmbledhura për zërat e bilancit, për të ardhurat dhe shpenzimet, për madhësinë e ekspozimeve të bankës ndaj rreziqeve të ndryshme, klasifikimeve brenda portofoleve të kredisë, madhësinë e provigjoneve për humbjet kryesisht nga rreziku i kredisë etj.

d) “Informacion material” është informacioni, i cili nëse nuk pasqyrohet ose shtrembërohet, mund të ndryshojë ose të ndikojë në vlerësimin ose vendimin e një përdoruesi, që mbështetet në këtë informacion.

e) “Informacion privat” është informacioni për produktet, shërbimet dhe sistemet e informacionit të një banke, publikimi i të cilit mund të dëmtojë pozicionin konkurrues të bankës në treg.

f) “Informacion konfidencial” është informacioni mbi klientët dhe/ose palët e tjera që lidhin kontrata me bankën, dhe që ruhet si i tillë (konfidencial) në bazë të akteve ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi.

Neni 5
Kategoritë e informacionit

1. Bankat publikojnë raportet periodike, që përfshijnë informacionin sipas gjashtë kategorive kryesore[1]:

a) veprimtaria kryesore e bankës, organizimi dhe drejtimi i përgjithshëm;

b) ecuria (performanca) financiare;

c) gjendja financiare (duke përfshirë kapitalin, aftësinë paguese dhe likuiditetin);

d) praktikat dhe strategjitë e administrimit të rrezikut;

e) ekspozimet ndaj rreziqeve (duke përfshirë rrezikun e kredisë, rreziqet e tregut, rrezikun e likuiditetit, rrezikun operacional, ligjor dhe rreziqet e tjera); dhe

f) politikat kontabël.

[1] Klasifikimi bëhet nga Komiteti i Bazelit.

2. Bankat pasqyrojnë këto kategori të informacionit, në përshtatje me vëllimin e veprimtarisë së tyre dhe me natyrën e operacioneve që ato ndërmarrin, duke respektuar nivelin e kërkuar sipas kësaj rregulloreje.

3. Informacioni që përfshihet në kategoritë e mësipërme paraqitet qartë dhe në mënyrë të përshtatshme, me qëllim që të arrihet një nivel i mjaftueshëm i transparencës bankare.

4. Bankat dërgojnë në Bankën e Shqipërisë një kopje të publikimeve të tyre.

5. Bankat nuk publikojnë informacione të klasifikuara në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si konfidenciale ose sekret mbi klientelën e tyre, apo informacione që ndikojnë në pozicionin konkurrues të tyre në treg.

Neni 6

Kërkesat për procedurat e publikimit dhe karakteristikat e informacionit

1. Bankat hartojnë dhe miratojnë akte të brendshme për procedurat e përgatitjes dhe publikimit të informacionit, si dhe për kontrollin e brendshëm në procesin e përgatitjes dhe publikimit, me qëllim vlerësimin e përshtatshmërisë së publikimeve si vlefshmërinë, integritetin, saktësinë dhe frekuencën e tyre.

2. Aktet e brendshme të bankës për publikimin e informacionit përcaktojnë informacionin, i cili do të klasifikohet material, privat dhe konfidencial, ndarjen e tij sipas kategorive të përdoruesve (depozitues, analistë, kredimarrës të mëdhenj, investitorë të mundshëm dhe/ose kategori të tjera përdoruesish), mjetet e tjera të komunikimit masiv që do të përdoren për publikim, përveç publikimeve me bazë letër, si dhe çështje të tjera me rëndësi për bankën.

3. Bankat publikojnë informacion mbi rreziqet ndaj të cilave ekspozohen në veprimtarinë e tyre, duke dhënë një pamje të gjithanshme të profilit të rrezikut.

4. Informacioni i publikuar nga bankat duhet të jetë material, që t'í shërbejë kërkesave vendimmarrëse të përdoruesve të tij dhe t'i ndihmojë ata në vlerësimin e rreziqeve dhe fitimeve të pritshme të investimeve të tyre, të ekspozimeve të tjera të mundshme dhe të ecurisë e të gjendjes financiare të ardhshme të veprimtarisë së bankave.

5. Bankat publikojnë informacionin me shtrirje kohore të mjaftueshme (periudha nga fundi i periudhës së raportuar deri në publikim), për të dhënë një pamje të kuptueshme të profilit të rrezikut të bankave dhe administrimit të tij.

6. Bankat publikojnë informacion të besueshëm, që pasqyron përmbajtjen ekonomike të ngjarjeve. Ky informacion duhet të jetë i verifikueshëm në çdo kohë, i plotë në të gjitha aspektet që paraqesin rëndësi për përdoruesin.

7. Bankat publikojnë të dhëna dhe tregues numerikë në raportet e publikuara, që kanë bazë krahasuese dhe që i referohen një ose disa periudhave të njëjta.

KREU II

MËNYRA DHE AFATET E PUBLIKIMIT TË INFORMACIONIT

Neni 7

Mënyra e publikimit të informacionit

1. Bankat publikojnë informacionin në gjuhën shqipe në një mënyrë të përshtatshme (të tillë si broshura informative ose/dhe në formë elektronike apo të afishuar në një tabelë njoftimi) në ambiente të përdorshme nga publiku, në zyrat qendrore dhe në të gjitha degët dhe agjencitë e tyre.

2. Bankat publikojnë informacionin në faqen e internetit, e cila punon jo më pak se 95 për qind të vitit.

3. Bankat marrin masat, që informacioni të jetë në përdorim deri në publikimin tjetër të

radhës.

4. Bankat publikojnë informacionin në gjuhën shqipe dhe mbi baza vullnetare edhe në gjuhë të huaj.

5. Bankat përdorin si shenjë dalluese në publikimet e tyre stemën e bankës.

Neni 8
Afatet e publikimit

1. Bankat publikojnë informacionin sipas kërkesave të kësaj rregulloreje, në raportet e tyre periodike.

2. Raporti i vlefshëm për periudhat tremujore (31 mars, 30 qershor dhe 30 shtator) publikohet brenda muajit pasardhës, pas mbarimit të tremujorit kalendarik, Ndërsa, raporti i tremujorit të katërt të vitit (31 dhjetorit) publikohet brenda muajit mars të vitit pasardhës. Raporti i plotë vjetor, publikohet brenda gjashtëmujorit të parë të vitit pasardhës.

3. Bankat shënojnë datën në të cilën publikojnë raportin dhe datën kur plotësojnë ose korrigjojnë informacionin e publikuar më parë, apo në rastin e publikimit të një informacioni shtesë apo plotësues, që i referohet të njëjtit informacion.

4. Informacioni sasior, që publikohet në raportet periodike tremujore, përfshin informacionin për tremujorin aktual së bashku me informacionin krahasues për periudhat e mëparshme.

KREU III
KËRKESAT MINIMALE PËR PUBLIKIM

Neni 9
Informacion mbi aktivitetin kryesor, organizimin, administrimin, drejtimin dhe kontrollin e bankave

1. Bankat publikojnë informacion rreth veprimtarisë/ve për të cilën/at janë licencuar, informacion mbi strukturën e aksionerëve, strukturën e organeve drejtuese dhe strukturën organizative të tyre.

2. Bankat publikojnë informacionin e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, sipas aneksit 1, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje.

Neni 10
Informacion mbi ecurinë e gjendjes financiare të bankave

Bankat publikojnë informacionin bazë mbi ecurinë dhe gjendjen financiare, që përmban kryesisht:

1. bilancin kontabël (aktiv-pasivet) dhe një informacion mbi zërat jashtë bilancit (transaksionet jashtë bilancit, angazhimet e financimit, instrumentet derivative etj.). Në shënimet sqaruese të bilancit jepet informacion shtesë për zërat e bilancit që i shërbejnë ose kanë lidhje me kërkesat e përdoruesve;

2. pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas natyrës ose funksionit brenda tyre, si dhe shënimet sqaruese që shoqërojnë këtë pasqyrë, të cilat japin të dhëna shtesë mbi kategoritë e rëndësishme të të ardhurave dhe shpenzimeve;

3. treguesit kryesorë të rentabilitetit, që përfshijnë treguesin e kthyeshmërisë nga aktivet (ROA), nga kapitali aksioner (ROE), marzhin neto nga interesat (të ardhurat neto nga interesat/aktivet mesatare që sjellin të ardhura), raportin e shpenzimeve me të ardhurat etj.;

4. kapitalin rregullator, vlerën, elementet përbërëse dhe veçoritë e tij, veçanërisht në

rastin e instrumenteve hibride, me qëllim që pjesëmarrësit e tregut të njohin aftësinë e bankave për të përballuar humbjet financiare. Këto publikime duhet të përfshijnë minimalisht strukturën e kapitalit rregullator me elementet përbërëse të tij;

5. mjaftueshmërinë e kapitalit, me qëllim që pjesëmarrësit e tregut të njohin lidhjen midis kapitalit të publikuar dhe ekspozimit dhe vlerësimit të rrezikut, duke përfshirë:

a) raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit mbi baza individuale dhe të konsoliduara për periudha tremujore;

b) vlerësime të ekspozimeve të rrezikut, të llogaritura sipas metodologjisë së përcaktuar në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë apo modeleve të brendshme të bankës;

c) analiza mbi faktorët kryesorë, që ndikojnë në pozicionin e mjaftueshmërisë së kapitalit;

6. informacionin e parashikuar në këtë nen, sipas aneksit 2, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje.

Neni 11

Informacion mbi ekspozimet ndaj rreziqeve

1. Bankat publikojnë informacion mbi parimet e përgjithshme, politikat dhe metodologjitë e administrimit të rrezikut, si dhe teknikat e zbutjes së rrezikut (për shembull instrumentet derivative).

2. Bankat identifikojnë dhe pasqyrojnë në informacionet që publikojnë, të gjitha rreziqet që janë të rëndësishme dhe relevante. Bankat publikojnë informacion kryesor cilësor dhe sasior lidhur me administrimin e rreziqeve të tilla, si më poshtë:

a) Për rrezikun e kredisë, bankat publikojnë:

<u>Informacion cilësor</u>

i) Informacion të përgjithshëm mbi politikat, strategjitë dhe metodat për identifikimin, administrimin, monitorimin dhe kontrollin e rrezikut të kredisë, duke përfshirë rolin e këshillit drejtues dhe të drejtuesve të tjerë ekzekutivë.

ii) Përkufizimin e kredive me probleme, kredive që u ka kaluar afati dhe kredive të ristrukturuara.

iii) Metodat e ndjekura për provigjionet statistikore dhe provigjonet për humbjet nga kreditë, si dhe të metodave statistikore të përdorura nga vetë banka (nëse ekzistojnë të tilla).

iv) Metodat dhe instrumentet e përdorura nga bankat, për të zbutur rrezikun e kredisë.

v) Llojet kryesore të kolateralit të pranuar nga bankat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe administrimin e tij.

<u>Informacion sasior</u>

i) Tepricën e kredive (bruto) dhe klasifikimin sipas kategorive respektive (standarde, në ndjekje, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura).

ii) Totalin e provigjoneve sipas kategorive respektive të kredive të klasifikuara.

iii) Totalin e kredive (bruto) të ristrukturuara gjatë periudhës korente.

iv) Vlerën e instrumenteve derivative për operacionet e mbulimit (*hedging*) dhe/ose në tërësi, të përdorura në veprimtarinë e bankës.

v) Klasifikime të portofolit të kredive sipas llojit, shpërndarjes gjeografike, sipas industrisë ose tipit të kundërpartisë, sipas maturitetit të mbetur dhe shumën e kredive që u ka kaluar afati dhe atyre me probleme.

vi) Vlerën e portofolit të kredive që sigurohen nga kolateralet e dhëna, garantuesit dhe/ose instrumentet derivative.

b) Për rreziqet e tregut, bankat publikojnë:

Informacion cilësor

Informacion të përgjithshëm mbi politikat e administrimit, metodat statistikore të përdorura në modelet e vlerësimit të rreziqeve, vlefshmërinë e modeleve të tyre dhe procedurat *stress- test*.

Informacion sasior

Kërkesat e kapitalit për rrezikun e normës së interesit, rrezikun nga kursi i këmbimit, si dhe vlerësimet VAR (nëse kryhen nga bankat).

c) Për rrezikun e normës së interesit, bankat publikojnë:

Informacion cilësor

i) Informacion të përgjithshëm mbi strategjitë dhe politikat e administrimit të këtij rreziku, si dhe mbi rolin e këshillit drejtues dhe drejtuesve të tjerë ekzekutivë në zhvillimin, rishikimin, miratimin dhe zbatimin e politikave të rrezikut të normës së interesit dhe programin, për monitorimin dhe kontrollin efektiv të këtij rreziku.

ii) Metodat për matjen e ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit.

iii) Në rastin e përdorimit të instrumenteve derivative, bankat duhet të publikojnë mënyrën e përdorimit të këtyre instrumenteve në administrimin e rrezikut të normës së interesit si dhe një informacion mbi shtrirjen e përdorimit të tyre.

Informacion sasior

Të dhëna numerike të hollësishme për nivelin e aktiveve dhe pasiveve, të ndjeshme ndaj normës së interesit dhe të ekspozimeve jashtë bilancit, të shoqëruara me skenarët përkatës (nëse ka) mbi lëvizjet e normave të interesit të përcaktuara nga banka.

d) Për rrezikun e kapitalit aksioner, bankat publikojnë llojet, vlerën dhe natyrën e investimeve në shoqëritë publike dhe private, si dhe rezultatin financiar të tyre.

e) Për rrezikun e kursit të këmbimit, bankat publikojnë:

Informacion cilësor

i) Informacion të përgjithshëm mbi politikat dhe procedurat e identifikimit, administrimit, monitorimit dhe kontrollit të rrezikut të normës së këmbimit.

ii) Burimet kryesore të rrezikut të kursit të këmbimit brenda portofolit të aktiveve në valutë, teknikat e përdorura për matjen e këtij rreziku, kufizimet që ato përcaktojnë dhe frekuencën e vlerësimit.

iii) Në rastin e përdorimit të instrumenteve derivative, bankat duhet të publikojnë mënyrën e përdorimit të këtyre instrumenteve për administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit, si dhe një informacion mbi shtrirjen e përdorimit të tyre.

Informacion sasior

i) Ekspozimet e bankës në monedha të veçanta dhe në tërësi, për gjithë monedhat.

ii) Të dhëna mbi vlerën e investimeve të bankës në filialet e huaja (rreziku i konvertimit të monedhës së huaj).

f) Për rrezikun operacional, bankat publikojnë llojet kryesore të ekspozimeve ndaj

rrezikut operacional, si dhe një përshkrim cilësor të përgjithshëm të modeleve të tyre, për të administruar dhe kontrolluar këtë lloj rreziku (nëse ekzistojnë të tilla).

g) Për rrezikun e likuiditetit, bankat publikojnë:

Informacion cilësor

i) Informacion të përgjithshëm për administrimin e likuiditetit, duke përfshirë zhvillimin, rishikimin, miratimin dhe zbatimin e politikave të administrimit të likuiditetit dhe procedurat e vendosura për monitorimin dhe kontrollin efektiv të këtij rreziku.

ii) Metodat e përdorura për vlerësimin e gjendjes aktuale të likuiditetit dhe parashikimin e nevojave për të ardhmen.

iii) Metodat e përdorura për administrimin e likuiditetit.

Informacion sasior

i) Niveli i aktiveve likuide dhe burimeve e përdorimeve të fondeve të bankave.

ii) Niveli i aktiv-pasiveve afatshkurtra.

iii) Niveli i burimeve të fondeve nga të tretët sipas maturitetit të mbetur.

iv) Një pasqyrë e fluksit të rrjedhjes së parave (*cash flow-t*).

v) Vlera e aktiveve të titullzuara etj. (nëse ka).

3. Bankat publikojnë informacionin e parashikuar në këtë nen, sipas aneksit 2, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 12
Informacion mbi politikat kontabël

1. Bankat publikojnë informacion mbi politikat kontabël të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare, në mënyrë që përdoruesi i informacionit të njohë si vlerësohen zërat e ndryshëm në këto pasqyra, për një interpretim të saktë të informacionit.

2. Bankat publikojnë informacion mbi politikat kontabël të përdorura për vlerësimin e aktiv - pasiveve, provigjoneve, të ardhurave etj.

KREU IV
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 13
Masa parandaluese dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton dispozitat e parashikuara në nenin 53, pika 5 dhe nenin 89 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

ANEKSI NR.1

1. Informacion i përgjithshëm mbi bankën (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime).

1.1 Bankat publikojnë:

a) emrin tregtar, formën juridike, adresën e regjistruar, numrin dhe datën e vendimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;

b) shumën e kapitalit të regjistruar sipas vendimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;

c) shumën e kapitalit të paguar;

d) tipin, formën, numrin e aksioneve të emetuara dhe vlerën nominale të tyre;

e) informacion mbi rritjet e kapitalit, nëse ka rritje të tij që nga publikimi i fundit mbi:

- mënyrën dhe nivelin e rritjes së kapitalit;

- tipin, formën, numrin e aksioneve të emetuara, vlerën nominale të tyre (në rastin e emetimit të një aksioni të ri);

- shumën e rritjes së kapitalit, burimin (fondet) e rritjes (në rastin e rritjes së kapitalit nga fondet e veta) dhe nëse rritet vlera nominale e aksioneve, jepet shuma sipas të cilës ajo do të rritet.

1.2 Bankat publikojnë informacion mbi aksionerët që kanë pjesëmarrje influencuese.

a) Në rastin e aksionerëve - persona juridikë, bankat publikojnë:

1. emrin tregtar;

2. formën juridike;

3. adresën e regjistruar;

4. përqindjen e aksioneve me të drejta votimi.

b) Në rastin e aksionerëve - persona fizikë, bankat publikojnë:

1. emrin dhe mbiemrin;

2. përqindjen e aksioneve me të drejta votimi.

2. Informacion i përgjithshëm mbi degët e bankave të huaja (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime).

Degët e bankave të huaja publikojnë:

a) emrin tregtar, formën juridike, selinë, numrin dhe datën e vendimit të regjistrimit;

b) shumën e kapitalit të dhuruar;

c) shumën e kapitalit të dhuruar, të paguar.

3. Informacion mbi strukturën e organizimit, të administrimit dhe të funksionimit të bankës dhe degës së bankës së huaj, duke përfshirë njësitë e saj funksionale dhe administrative, funksionet e tyre dhe marrëdhëniet raportuese dhe kontrolluese (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime)

3.1 Bankat publikojnë informacion mbi administrimin e bankës:

a) strukturën organizative, numrin e njësive organizative dhe numrin e punonjësve;

b) strukturën e organeve drejtuese si këshillit drejtues dhe drejtorisë, autoritetet dhe përgjegjësitë e tyre;

c) kualifikimet dhe përvojën e anëtarëve të këshillit drejtues, komitetit të kontrollit dhe drejtuesve ekzekutivë të bankave;

d) strukturën e pronësisë (për shembull, aksionerët kryesorë dhe të drejtat e votimit), pjesëmarrjen e aksionerëve kryesorë në këshillin drejtues ose në drejtorinë e bankës;

e) kodin e etikës dhe politikën e drejtimit të veprimtarisë, në veçanti përmbajtja e ndonjë kodi apo politike qeverisëse dhe procesi sipas të cilit është zbatuar apo një vlerësim nga këshilli drejtues i përformancës së tij lidhur me këtë kod ose politikë;

f) politikën e bankës lidhur me konfliktet e interesave, si dhe natyrën dhe nivelin e transaksioneve me filialet dhe personat/klientët e lidhur.

3.2 Bankat publikojnë informacion mbi strukturën e grupit të konsoliduar, të cilit ato i përkasin (nëse ekziston grupi bankar):

1. emrin tregtar, formën juridike dhe adresën e regjistruar të sipërmarrjeve që përbëjnë grupin e konsoliduar, ndërsa në rastin e personit fizik, jepet emri dhe mbiemri;

2. emrin tregtar, formën juridike dhe adresën e regjistruar të sipërmarrjeve në të cilat bankat janë sipërmarrje mëmë ose aksionere kryesore;

3. emrin tregtar, formën juridike dhe adresën e regjistruar të sipërmarrjeve, të cilat janë sipërmarrje mëmë ose aksionere kryesore në banka;

4. Informacion mbi aktivitetet e bankave (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime).

Bankat publikojnë informacion mbi aktivitetin e tyre si më poshtë:

a) një listë të veprimtarive sipas licencës së marrë;

b) një listë të veprimtarive që ato aktualisht kryejnë.

5. Informacion mbi filialet e bankave dhe sipërmarrjet në të cilat bankat janë aksionere kryesore (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime).

Bankat publikojnë:

a) emrin tregtar, formën juridike dhe adresën e regjistruar;

b) përqindjen e pjesëmarrjes direkte ose indirekte, në kapitalin e një sipërmarrjeje të tillë;

c) përqindjen e pjesëmarrjes direkte ose idirekte, në të drejtat e votimit në një sipërmarrje të tillë;

d) çdo mënyrë tjetër të kontrollit të ushtruar;

e) numrin, vlerën nominale dhe çmimin e blerjes të aksioneve dhe çdo ndryshim të bërë gjatë periudhës aktuale;

f) shumën e vlerave për t'u arkëtuar dhe për t'u paguar nga bankat në lidhje me një sipërmarrje të tillë;

g) shumën e letrave me vlerë, të cilat janë lëshuar nga sipërmarrjet e tilla dhe shumën e vlerave të pagueshme nga letra të tilla me vlerë;

h) shumën e garancive të lëshuara nga bankat për sipërmarrje të tilla dhe shumën e garancive të pranuara nga bankat, nga sipërmarrje të tilla.

6. Informacion mbi sipërmarrjet mëmë dhe sipërmarrjet aksionere kryesore në banka (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime).

6.1 Bankat publikojnë:

a) emrin tregtar, formën juridike dhe adresën e regjistruar (në rastin e personit fizik jepet emri dhe mbiemri);

b) përqindjen e pjesëmarrjes direkte ose indirekte, në kapitalin e bankave;

c) përqindjen e pjesëmarrjes, direkte ose indirekte, të të drejtave të votimit të bankave;

d) ndonjë mënyrë tjetër e kontrollit, e ushtruar;

e) shumën e vlerave të arkëtueshme dhe të pagueshme të bankave ndaj sipërmarrjeve të tilla;

f) shumën e letrave me vlerë të cilat janë emetuar nga sipërmarrje të tilla, dhe shumën e vlerave të pagueshme (bank's payables) nga këto letra me vlerë;

g) shumën e garancive të lëshuara nga bankat për këto sipërmarrje dhe shumën e garancive të pranuara nga bankat për sipërmarrje të tilla.

6.2 Në rastin e një sipërmarrjeje mëmë në një banke, është i mjaftueshëm publikimi i informacionit sipas paragrafit 4.1.

7. Informacion i degës së bankës së huaj lidhur me bankën-mëmë (çdo tremujor).

Dega e bankës së huaj publikon raportet financiare tremujore dhe vjetore të bankës – mëmë si më poshtë:

a) raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit;

b) kapitalin rregullator (fondet e veta);

c) treguesin e kredisë me probleme ndaj totalit të kredisë;

d) treguesin e kredisë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator (fondet e veta);

e) treguesin e shumës së fondeve rezervë për humbjet nga kreditë ndaj kredive me probleme;

f) reguesin e aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve;

g) raportet financiare tremujore më të fundit të bankës-mëmë;

h) raportin më të fundit të ekspertit kontabël të autorizuar për bankën-mëmë;

i) vlerësimin e performancës së bankës-mëmë nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit (shoqëritë e *rating-ut*).

ANEKSI NR.2

A. Informacion mbi ecurinë e gjendjes financiare të bankave (çdo tremujor)

Tabela 1

Bilanci kontabël, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe në veçanti tregues të rentabilitetit

Informacion cilësor	a)	Informacion i përgjithshëm në formën e analizave dhe komenteve të shkruara, për ecurinë e gjendjes financiare të bankës sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.
Informacion sasior	b)	- Bilanci kontabël (aktiv-pasivet) dhe zërat jashtë bilancit (formularët nr. 20, 21 dhe 23 sipas SRU); - Pasqyra e llogarisë "të ardhura dhe shpenzime" (formulari nr.22, sipas SRU); - Tregues të rentabilitetit si më poshtë: 1. kthyeshmëria nga aktivet mesatare (ROAA) = të ardhurat neto/aktivet mesatare *100; 2. rezultati neto i jashtëzakonshëm / aktivet mesatare; 3. shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë; 4. të ardhurat neto nga interesi / shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë; 5. kthyeshmëria nga kapitali aksionar mesatar (ROAE) = të ardhurat neto / kapitali aksioner mesatar *100; 6. aktive për punonjës = totali i aktiveve/ numri i regjistruar i punonjësve; 7. të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare; 8. të ardhurat nga interesat / aktivet mesatare; 9. shpenzime për interesa / aktivet mesatare; 10. të ardhurat neto nga interesat / të ardhurat bruto të veprimtarisë; 11. të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera / aktivet mesatare; 12. shpenzimet jo për interesa / të ardhurat bruto të veprimtarisë; 13. shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë; 14. shpenzime për provigjone / aktivet mesatare.

Tabela 2

Struktura e kapitalit rregullator

(SRU formulari nr.30, udhëzimi "Për kapitalin rregullator të bankës")

Informacion cilësor	a)	Informacion i përmbledhur mbi veçoritë kryesore të instrumenteve të kapitalit, veçanërisht në rastin e instrumenteve hibride
Informacion sasior	b)	Kapitali bazë (1+2). Elemente përbërëse që shtohen (1): - kapitali i nënshkruar; - rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit); - primet e emetimit dhe të fuzionimit (shkrirjes, bashkimit); - fitimet e pashpërndara (të bartura); - fitimi ushtrimor i fundit të vitit; - fitimi ushtrimor i periudhës raportuese; - diferenca rivlerësimi kreditore.

		Elemente përbërëse që zbriten (2): - kapitali i nënshkruar, i papaguar; - vlera emërore e aksioneve të bankës të mbajtura nga banka (të - pashitura, të riblera); - humbjet e pashpërndara (të bartura); - humbja ushtrimore; - diferenca rivlerësimi debitore; - aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara.
	c)	Kapitali shtesë (3) Elemente përbërëse të kapitalit shtesë (3): - rezervat e rivlerësimit; - rezervat e përgjithshme; - detyrimet e varura: instrumentet hibride dhe detyrimet e varura me afat;
	d)	Zbritjet nga kapitali bazë dhe shtesë sipas udhëzimit dhe akteve të tjera rregullative të Bankës së Shqipërisë.
	e)	Totali i kapitalit rregullator

Tabela 3
Mjaftueshmëria e kapitalit
(Rregullorja për "Raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit")

Informacion cilësor	a)	Modeli i vlerësimit të bankës për mjaftueshmërinë e kapitalit (nëse ekziston një e tillë përndryshe metoda e përcaktuar në rregulloren e Bankës së Shqipërisë);
Informacion sasior	b)	Kërkesa për kapital për mbulimin e rrezikut të kredisë: - aktivet e ponderuara me rrezikun (formulari 12); - zërat jashtë bilancit që përfaqësojnë kontrata të instrumenteve financiare mbi normat e interesit dhe kurset e këmbimit, të ponderuara me rrezikun (formulari 13); - zëra të tjerë jashtë bilancit (formulari 14).
	c)	Kërkesa për kapital për mbulimin e rreziqeve të tregut, të lidhura me normat e interesit dhe kursin e këmbimit (VF – formulari 39).
	d)	Kërkesa për kapital për mbulimin e rrezikut operacional (modeli i vlerësimit nëse ekziston).
	e)	1. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (formulari 15). 2. Raporti i modifikuar i mjaftueshmërisë së kapitalit (formulari 15).

B. Ekspozimet ndaj rreziqeve dhe vlerësimi i tyre

Tabela 4
Rreziku i kredisë: Informacion i përgjithshëm
(Rregullorja për "Administrimin e rrezikut të kredisë)
(çdo tremujor)

Informacion cilësor	a)	Kërkesa për informacion të përgjithshëm që lidhet me rrezikun e kredisë sipas kërkesave të rregullores, që përfshin: - përkufizimin e kredive me probleme (rregullorja për "Administrimin e rrezikut të kredisë"; - përshkrimin e metodës së përdorur për provigjonet statistikore dhe për humbjet nga kreditë (nëse ka banka një të tillë, përndryshe rregullorja "Për administrimin e rrezikut të kredisë"); - politikën e bankës për administrimin e rrezikut të kredisë; - përshkrimin e natyrës së ekspozimit brenda çdo portofoli (sipas metodës se bankës nëse ka një të tillë) dhe planet e afatet kohore të drejtimit të bankës, për zbatimin e kësaj metode.
Informacion sasior	b)	Teprica bruto e kredisë, teprica mesatare bruto e kredisë gjatë periudhës tremujore, sipas llojeve kryesore të ekspozimeve të kredisë.
	c)	Klasifikime të portofolit të kredive sipas shpërndarjes gjeografike.
	d)	Klasifikime të portofolit të kredive sipas industrisë ose tipit të kundërpartisë.
	e)	Klasifikime të portofolit të kredive sipas maturitetit të mbetur (kontraktual).
	f)	Shuma e kredive që u ka kaluar afati dhe atyre me probleme sipas klasifikimit (d), dhe shpenzimeve për provigjone brenda këtij klasifikimi.
	g)	Shuma e kredive që u ka kaluar afati dhe atyre me probleme sipas klasifikimit (c), dhe shpenzimeve për provigjone brenda këtij klasifikimi.
	h)	Fondet për provigjone dhe lëvizjet gjatë periudhës (shtesa +, pakësime -).

Tabela 5
Rreziqet e tregut: Informacion i përgjithshëm
(Rregullorja "Mbi rreziqet e tregut")
(çdo gjashtëmujor)

Informacion cilësor	a)	Informacion i përgjithshëm cilësor, për rreziqet e tregut sipas kërkesave të rregullores.
Informacion sasior	b)	Kërkesa për kapital për: - rrezikun nga normat e interesit; - rrezikun nga kursi i këmbimit.

Tabela 6
Rreziku operacional
(çdo tremujor)

Informacion cilësor	a)	Informacion i përgjithshëm për metodën e përdorur në vlerësimin e rrezikut operacional (nëse ekziston).
Informacion sasior	b)	Kërkesa për kapital për rrezikun operacional.

Tabela 7
Rreziku i likuiditetit
(çdo tremujor)

Informacion cilësor	a)	Informacion i përgjithshëm sipas kërkesave të rregullores
Informacion sasior	b)	- Niveli i aktiveve likuide dhe burimeve e përdorimeve të fondeve të bankave. - Niveli i aktiv-pasiveve afatshkurtra. - Niveli i burimeve të fondeve nga të tretët sipas maturitetit të mbetur. - Një pasqyrë e fluksit të rrjedhjes së parave (*cash flow-t*). - Vlera e aktiveve të titullzuara (nëse ka) etj.

C. Tregues të ekspozimit të degës së bankës së huaj ndaj rreziqeve

Tabela 8
Depozita ekuivalente e kapitalit
(çdo muaj)

Nr.	Depozita ekuivalente e kapitalit (DEK-a):	Shuma
1.	Depozitë në Bankën e Shqipërisë me normë interesi të përcaktuar me marrëveshje midis tyre.	
2.	Bono thesari dhe obligacione të emetuara nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.	
3.	Letra me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë.	
	SHUMA	

Tabela 9

Matja dhe kontrolli i kufijve të rrezikut
(çdo tremujor)

Kodi	Treguesit (në mijë lekë)	
1	Totali i aktiveve në fund të tremujorit paraardhës	
2	Teprica e kredisë e tremujorit raportues	
3	Raporti tepricë kredie / total i aktiveve (në %) (2:1 x100)	

4	Kufiri maksimal i rrezikut	70%